



**ZP.Anr. 1/2026**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Kujtim Pasuli, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), me seli në Prizren e paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me refuzimin e nominimit të z Shaban Papiç për anëtar të KKZ-së, në Komunën e Prizrenit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen me date 07 Qershor 2026, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.05.2026, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet e pabazuar ankesa ZP.Anr.1/2026**, e datës 08.05.2026, e subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), me seli në Prizren, e paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me refuzimin e nominimit të z Shaban Papiç për anëtar të KKZ-së, në Komunën e Prizrenit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen me date 07 Qershor 2026.

## A r s y e t i m

**PZAP-i**, ka pranuar ankesën ZP.Anr.1/2026, me datën 08.05.2026, nga subjekti politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP), në të cilën theksohet subjekti politik Kosova Demokratik Turk Partisi - KDTP, paraqet këtë ankesë ndaj vlerësimit dhe veprimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përmes të cilit është kërkuar zëvendësimi i kandidatit të propozuar për anëtar të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në Komunën e Prizrenit, z Shaban Papiç. Pala ankuese thekson se në njoftimin e KQZ-së, arsyetimi mbështetet në Vendimin nr. 01/86-2026, datë 19.01.2026<sup>1</sup> lidhur me ndërprerjen e mandatit të përfaqësuesve politikë të KKZ-së, në Komunën e Prizrenit, dhe se ky vendim nuk përmban konstatim të përgjegjësisë individuale ndaj z. Shaban Papiç, nuk përcakton ndonjë ndalim individual për ushtrimin e funksioneve zgjedhore dhe nuk paraqet vendim disiplinor apo ndëshkues të formës së prerë ndaj tij. Tutje në ankesë theksohet se përkundër mungesës së një vendimi individual dhe përfundimtar nga organet kompetente, ndaj z. Shaban Papiç është krijuar efekt kufizues faktik, duke ia pamundësuar ushtrimin e funksionit për të cilin është nominuar nga subjekti politik KDTP. Po ashtu, pala ankuese thekson se z, Shaban Papiç, në kuadër të procedurës së nominimit, ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga KQZ-ja, përfshirë edhe vërtetimin nga organet kompetente gjyqësore, me të cilin dëshmohet se ndaj tij nuk ekziston ndonjë ndalesë ligjore apo pengesë juridike për ushtrimin e funksioneve zgjedhore.

Pala ankuese duke u bazuar në sa më sipër, kërkon nga PZAP që: ta aprovojë këtë ankesë si të bazuar, ta anulojë vlerësimin/veprimin e KQZ-së lidhur me refuzimin e nominimit të z. Saban Papiç, të konstatojë se ndaj z. Şaban Papiç nuk ekziston ndonjë ndalesë juridike për ushtrimin e funksionit të anëtarit të KKZ-së, dhe ta obligojë KQZ-në, që ta aprovojë nominimin e propozuar nga subjekti politik KDTP për anëtar të KKZ-së në Komunën e Prizrenit.

Në përgjigjen në ankesë KQZ-ja, sqaron se bazuar në nenin 67 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe në Rregulloren Zgjedhore Nr. 02/2024 për Emërimin, Përbërjen dhe Funksionimin e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve, është e rregulluar në mënyrë të detajuar procedura e emërimit, përbërjes dhe funksionimit të KKZ-ve, si dhe kriteret që duhet të plotësohen nga personat e propozuar nga subjektet politike për këto funksione. Me qëllim të sqarimit të plotë të rrethanave theksohet se, KQZ më datën 01.05.2026, me vendimin Nr.01/574/2026, ka miratuar formulën për anëtarët e KKZ, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 7 qershor 2026, ndërsa më datën 02.05 2026 ju ka dërguar subjekteve politike ftesën për nominim të anëtarëve të KQZ. Poashtu KQZ në përgjigje thekson se më datën 07.05.2026, KQZ përmes email-it i ka dërguar kërkesë subjektit politik KDTP, për zëvendësimin e kandidatit të nominuar z. Saban Papiç, për KKZ në Prizren, meqenëse i njëjti person ka qenë i angazhuar në procesin zgjedhor të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 28 dhjetor 2025, dhe lidhur këtë KQZ në kuptim të nenit 70 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës si dhe nenit 6 të Rregullores Zgjedhore Nr. 02/2024, me datën 19.01.2026, ka marrë vendim për ndërprerjen e mandatit të përfaqësuesve politik të në Prizren, meqenëse në komunën e Prizrenit janë evidentuar mbi 80% e pasaktësive në votat e kandidatëve, të cilat përbëjnë cenim serioz të rregullsisë dhe besueshmërisë së procesit të numërimit. Në këtë kontekst, KQZ thekson se edhe pas emërimit të një anëtarit të Komisioni Qendror i Zgjedhjeve gëzon kompetencë të plotë ligjore për të ndërhyrë në rast se paraqiten rrethana që cenojnë integritetin, besueshmërinë apo paanshmërinë e ushtrimit të detyrës. Në pajtim me nenin 70 të Ligji Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe neni 6 paragrafi 3 i Rregullores Zgjedhor Nr. 02/2024, KQZ ja mund ta revokojë në çdo kohë emërimin e secilit anëtar të kur vlerëson se ekzistojnë arsye që e bëjnë të papërshtatshëm vazhdimin e ushtrimit të funksionit, kjo kompetencë përbën një mekanizëm të drejtpërdrejtë ligjor për mbrojtjen e integritetit të administrimit zgjedhor, përtej fazës së emërimit fillestar.

Në këtë fazë të procesit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk ka asnjë detyrim ligjor që të riemërojë të njëjtët persona që kanë shërbyer më parë si anëtarë të KKZ-së, dhe se emërimi i tyre në këto funksione gjatë zgjedhjeve të kaluara nuk krijon të drejtë të fituar për ri emërim për zgjedhjet e datës 7 qershor 2026, por mbetet kompetencë diskreionale e KQZ-së, Andaj, mos emërimi i të nominuarit në fjalë, është masë parandaluese administrative me qëllim të mbrojtjes së integritetit të procesit zgjedhor dhe ruajtjes së besimit publik. Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur gjithashtu se pala ankuese, nuk ka bashkëngjitur prova që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e paraqitura në ankesë. Përgjigjes në ankese KQZ ka bashkëngjitur dëshmitë si vendimin e datës 01.05.2026 Nr.01/574/2026, për miratimin e formulës për anëtarët e KKZ, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 7

qershor 2026, Email-in - ftesën për subjektet politike për nominim të anëtarëve të KQZ; Email-in - kërkesën e KQZ për subjektin politik KDTP, për zëvendësimin e kandidatit të nominuar z. Saban Papiç, për në Prizren; Vendimin Nr.01/86/2026 i datës 19.01.2026, për ndërprerjen e mandatit të përfaqësuesve politik të KKZ në Prizren, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 28 dhjetor 2025; Emal-in i dërguar për votim përmes procedurës qarkulluese, (së bashku me rendi i ditës Nr.44/2026, për votim në procedurë qarkulluese, rekomandimin, Listën dhe opinionin ligjor); Vendimi i KQZ për emërimin e anëtarëve të KKZ i datës Nr,01/698/2026.

PZAP-i, pasi bëri vlerësimin e deklarimeve të palëve, përgjigjes në ankesë dhe duke u mbështetur në dispozitat e nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e pa bazuar**

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, vlerësoj se bazuar në pretendimet ankimore të ankuesit vlerëson se pretendimet e palës ankuese janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj si të pabazuara, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk është arritur që të vërtetohet se KQZ-ja, ka bërë vlerësimin dhe veprimin përmes të cilit është kërkuar zëvendësimi i kandidatit të propozuar për anëtar të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në Komunën e Prizrenit, z Shaban Papiç, në arsyetimin e mbështetur në Vendimin nr. 01/86-2026, datë 19.01.2026, lidhur me ndërprerjen e mandatit të përfaqësuesve politikë të KKZ-së, në Komunën e Prizrenit.

Andaj, PZAP duke u bazuar në shkresat e lëndës, pretendimet e parashtruesit të ankesës janë të pa bazuara, pasi që në bazë të Vendimit Nr.01/86/2026 i datës 19.01.2026, KQZ ka marrë vendim për ndërprerjen e mandatit të përfaqësuesve politik të në Prizren, pasi që në komunën e Prizrenit janë evidentuar mbi 80% e pasaktësive në votat e kandidatëve, të cilat përbëjnë cenim serioz të rregullsisë dhe besueshmërisë së procesit të numërimit, i cili vendim është i formës se prere dhe ankuesi nëse do të konsideronte si jo të drejt këtë vendim atëherë në atë kohe ka pasur mundësi të parashtronte këto pretendime ankimore ndaj këtij vendimi, e jo në këtë fazë të procedurës. Ankuesi nuk ka bashkëngjitur asnjë prove të vetme për të mbështetur pretendimet e paraqitura në ankesë. Në këtë kontekst Paneli konstaton se KQZ me Email-in - ftesën për subjektet politike për nominim të anëtarëve të KKZ dhe Email-in - kërkesën e KQZ për subjektin politik KDTP, për zëvendësimin e kandidatit të nominuar z. Saban Papiç, për në Prizren, nga e cila prove kuptohet se KQZ i ka dhënë mundësi ankuesit të nominoj zëvendësimin e anëtarit të KKZ.

Ndërsa lidhur me pretendimet tjera përkitazi me mungesën e arsyetimit nga KQZ, Paneli vlerëson se në bazë të parag.11 nenit 63 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës parashihet se “Të gjitha vendimet e KQZ-së janë dokumente publike dhe sigurojnë përmbushjen e elementeve të aktit administrativ, siç përcaktohet në ligjin në fuqi për Procedurën e Përgjithshme Administrative”. Ndërsa neni 44 LPPA parasheh se akti administrativ është çdo manifestim vullneti i një organi publik, që rregullon në mënyrë të njëanshme një marrëdhënie juridike konkrete të së drejtës administrative, me qëllim prodhimin e pasojave juridike, dhe u drejtohet një ose disa personave individualisht të përcaktuar apo një grupi personash, të përcaktuar apo të përcaktueshëm, në bazë të karakteristikave të përgjithshme. Sa i përket pretendimeve ankimore se ankuesi është vënë në

pozitë të pa barabartë në raport me anëtarët tjerë në rrethana të njëjta, ankuesi nuk ka bashkangjitur asnjë provë për të dëshmuar se anëtarët në një situatë të njëjtte apo krahasuesë janë përfshirë si anëtar të KKZ.

Andaj Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruar në ankesën e parashtruar, parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj me asnjë provë të vetme se me këto veprime nga ana e KQZ-së, ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nën përcaktohet se “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”.

Prandaj, nga arsyet e parashtruara më lart dhe në pajtim me nenin 13 paragrafi 2 dhe neni 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6, të Rregullores, së PZAP-it Nr.01/2025, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, si dhe nenit 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke e refuzuar ankesën si të pabazuar.

#### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

ZP.Anr.1/2026 më datën 09.05.2026



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzetetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.